



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 22.35.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË
KLLOKOTIT
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017

Prishtinë, Qershor 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të komunës së Klllokotit, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Udhëheqësja e Ekipit Svetlana Peroviq dhe Anëtari Mehmet Kurti, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Luljeta Morina.


TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	12
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	27
5 Qeverisja e mirë.....	28
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	31
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake.....	34
Shtojca III: Letër konfirmimi	42

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të komunës së Klllokotit për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 16/03/2018. Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017, drejtpërdrejtë e reflektojnë kualitetin e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i komunës së Klllokotit.

Zyra Kombëtare e Auditimit falënderon stafin e Komunës, për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i kualifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017, *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale përveç çështjeve:*

- Keq-klasifikimeve, pagesave të pagave si dhe mallrave dhe sherbimeve në vlerë 22,414€, të ekzekutuara nga kategoria e investimeve kapitale; dhe
- Shuma e granteve të përcaktuara të donatorëve ishte mbivlerësuar për 18,303€, si dhe buxheti për të hyrat tatimore dhe jo-tatimore ishte mbivlerësuar për 7,307€.

Theksimi i çështjes

Si theksim të çështjes, duam të përmendim faktin se komuna nuk kishte prezantuar pasuritë (investimet e bëra nga donacionet në vitin 2017) në vlerë prej 25,789€. Gjithashtu, toka në pronësi të komunës e cila është dhënë me qira nuk është e regjistruar si pasuri.

Për më gjerësisht shih pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2017**

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e vitit 2017. Ne kemi analizuar veprimtarinë e komunës së Klllokotit se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP).

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i Kualifikuar me Theksim të Çështjes

Ne kemi audituar PFV-të Komunës së Kllokotit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, përveç efektit të çështjes së përshkruar në paragrafin për Bazën për Kualifikim të Opinionit, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kualifikuar opinionin e auditimit për faktin se:

- Pas ankesës se tre nëpunësve komunal, thesari, bazuar në vendimet gjyqësore ka ekzekutuar pagesat për paga nga kategoria e investimeve kapitale në vlerë 11,946€;
- Përveç kësaj, për shpenzimet për mallra dhe shërbime (riparimin e automjetit), thesari, bazuar në vendimet gjyqësore ka ekzekutuar pagesat nga kategoria e investimeve kapitale në vlerë 10,468€;
- Te neni 14, Raporti mbi ekzekutimin e buxhetit, shuma e granteve të përcaktuara të donatorëve ishte mbivlerësuar për 18,303€, pasi që komuna gabimisht ka prezantuar edhe donacionet e bartura nga viti i kaluar; dhe
- Te neni 14, Raporti mbi ekzekutimin e buxhetit, buxheti për të hyrat tatimore dhe jo-tatimore ishte prezantuar gabimisht në vlerë 111,604€, derisa vlera e buxhetuar ishte 104,297€, më diferencë për 7,307€.

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Sipas kërkesave etike që janë relevante për auditimin tonë të Pasqyrave Vjetore Financiare të organizatave buxhetore në Kosovë, ZKA është e pavarur nga Komuna dhe përgjegjësitë e tjera etike janë përmbushur në përputhje me këto kërkesa. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se vlera e pasurisë së regjistruar në regjistrin e pasurisë dhe e paraqitur në PFV nuk ishte e plotë, sepse komuna nuk kishte prezantuar pasuritë (investimet e bëra nga donacionet në vitin 2017) në vlerë prej 25,789€. Gjithashtu, toka në pronësi të komunës¹ e cila është dhënë me qira nuk është e regjistruar në regjistrin kontabël si dhe e shpalosur në PFV. Sipas Zyrtarit Kryesor Financiar, mos regjistrimi i pasurisë është pasojë e neglizhencës së zyrtarit të pasurisë.

Opinionin ynë nuk është i kualifikuar në lidhje me këtë çështje.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Kryetari i Komunës së Klllokotit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, si dhe është

¹ Parcela P-73701026-00974-64 sipërfaqja 3,519m²; P-73701026-00974-61 sipërfaqja 323m²; P 974/45 sipërfaqja 4,557m²; P 1180-3 sipërfaqja 700m²; P 974-41 sipërfaqja 2,603m²; dhe P 974-44 sipërfaqja 2,256m²

përgjegjës për kontrolle të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Kërkohet që komuna të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimtimit për adresimin e rekomandimeve; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve;
- Raportet tremujore përfshirë edhe raportin nëntëmujor;
- Raportet operative (të performancës); dhe
- Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit më kohë.

Përpos çështjeve të cilat janë prezantuar të opinionit të auditimit, ne kemi identifikuar edhe disa gabime në shpalosjet e PFV-ve, si:

- Të hyrat në vlerë totale 789€ të grumbulluara në muajt: shtator, nëntor, dhjetor 2017, janë deponuar në bankë në vitin 2018, në të cilin edhe janë evidentuar. Si pasojë të hyrat për vitin 2017 janë nënvlerësuar për të njëjtën vlerë;
- Të hyrat e grumbulluara gjatë vitit 2016 në vlerë 1,150€ janë deponuar dhe paraqitur si të hyra të realizuara në vitin 2017, duke mbivlerësuar të hyrat e këtij viti;
- Te neni 16, Raporti i të arkëtueshmeve, nuk janë prezantuar të arkëtueshmet në emër të ofrimit të shërbimeve për grumbullimin e mbeturinave;
- Te neni 18, Detyrimet kontingjente, në vlerë 97,665€ është paraqitur gabimisht në kuadër të nenit 17, Pasqyra e detyrimeve të papaguara;
- Te neni 19, Pasuritë kapitale mbi 1,000€ nuk janë kategorizuar ndarazi: ndërtesat, tokat, pajisjet, makinat dhe automjetet;
- Te neni 20, Raporti mbi paradhëniet/avanset e pa justifikuar/pa mbyllura, janë paraqitur në vlerë 8,500€, deri sa vlera e tyre ishte 10,928€, me diferencë 2,428€; dhe
- Te neni 19.3.2, Pasuritë nën vlerën 1,000€ nuk është prezantuar për shkak se komuna nuk ka evidenca për to.

Të gjeturat më lartë, tregojnë që përgatitja e PFV-ve është menaxhuar në mënyrë të dobët.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë përveç çështjeve të paraqitura në opinionin e auditimit.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, kemi vërejtur se komuna nuk e ka përgatitur raportin vjetor të performancës, që është kërkesë ligjore e komunës.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjet e sipër përmendura ne japim rekomandimet, si në vijim:

Rekomandimi 1 Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për kualifikimin e opinionit dhe theksimit të çështjes, në këtë raport. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i forcuar kontrollet për të siguruar se të gjitha shpenzimet klasifikohen drejtë sipas kategorive ekonomike si dhe pasqyrat prezantohen në përputhje me kërkesat e rregullores së MF-së për raportimin vjetor financiar. Po ashtu, kryetari duhet të siguroj se të gjitha pasuritë komunale janë të evidentuara në regjistrat e pasurisë (regjistri kontabël dhe regjistri i pasurisë) dhe shpalosen drejtë në PFV-të e vitit 2018.

Më tutje, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve për vitin 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore pasuritë, si dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në fushën e MFK, prokurimi vazhdon të mbetet fusha ku janë identifikuar shumë dobësi, si rezultat i moszbatimit të rregullave. Sfida kryesore me të cilën ballafaqohet komuna është niveli shumë i ulët i realizimit të buxhetit të investimet kapitale në vetëm 18%. Niveli i ulët i realizimit nënkupton më pak projekte për qytetarët.

Gjithashtu, kontrollet mbi të hyrat nuk janë tërësisht të përshtatshme dhe nuk zbatohen në mënyrë efektive, veçanërisht në rastin e mbledhjes së të hyrave nga ofrimi i shërbimeve komunale, të cilat kanë rezultuar me mospërputhjen e të hyrave të faturuara, të paguara dhe të prezantuara. Fushat kryesore ku nevojiten kontrolle të shtuara janë shpenzimet për mallra dhe subvencione.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	1,046,321	1,230,951	908,325	870,742	853,340
Granti i Qeverisë -Buxheti	942,024	944,119	760,323	748,743	770,847
Të bartura nga viti paraprak ³		156,153	92,690	0	0
Të hyrat vetjake ⁴	104,297	104,297	29,273	105,128	82,493
Donacionet		26,382	26,039	16,871	0

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

³ Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁴ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Nga tabela më lartë shohim se realizimi i shpenzimeve nuk është në përputhje me buxhetin e planifikuar. Parashikimi dhe planifikimi jo adekuat i buxhetit kanë ndodhur për shkak të faktit se buxheti fillestar nuk përfshin planifikimin e shpenzimeve nga të hyrat vetanake të pa shpenzuara të transferuara/bartura nga vitet e mëparshme, si dhe donacioneve.

Buxheti final në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 184,630€ apo 18%. Kjo rritje është rezultat i të hyrave vetanake të bartura nga vitet 2014, 2015 dhe 2016 në vlerë 156,153€, donacioneve të jashtme në vlerë 26,382€, si dhe Grantit të Qeverisë në vlerë 2,095€.

Shpenzimet buxhetore në vitin 2017 ishin në nivelin 74% të buxhetit final ose 908,325€, me rënie prej 21% krahasuar me vitin 2016 (95%).

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	1,046,321	1,230,951	908,325	870,742	853,340
Pagat dhe Mëditjet	672,335	674,430	674,430	683,237	672,928
Mallrat dhe Shërbimet	99,191	145,717	119,065	126,762	124,623
Shërbimet komunale	17,200	30,017	21,949	17,200	17,155
Subvencionet dhe Transferet	6,644	27,994	27,874	6,944	1,999
Investimet Kapitale	250,951	352,793	65,007	36,599	36,635

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore, rishpërndarja e tyre fillestare dhe përfundimtare, si dhe dallimet në shpenzimet që kanë ndikuar në ndryshimet në nivelin e përgjithshëm të shpenzimit janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti përfundimtar për kategorinë e pagave dhe mëditjeve u rrit me 2,095€ nga Granti i Qeverisë për të shlyer deficitin, për shkak të supozimeve buxhetore fillestare të pasakta për këtë kategori;
- Pas rritjes së buxhetit final për mallra dhe shërbime për 46,526€, janë shpenzuar 82% e buxhetit që ishte në dispozicion. Gjendje e ngjashme ekziston edhe te shërbimet komunale ku, përkundër rritjes së buxhetit për 12,817€, është shpenzuar vetëm 73% e buxhetit;
- Buxheti për subvencione dhe transfere është rritur për 21,350€ (nga të hyrat vetanake të bartura nga viti paraprak në vlerë 5,350€ dhe të hyrave nga 2014/2015 në vlerë 16,000€). Ekzekutimi i kësaj kategorie të shpenzimeve është në nivelin 100%; dhe
- Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar është rritur për 101,842€, si rezultat i bartjes së të hyrave vetjake nga viti 2016 në vlerë prej 76,052€ dhe donacioneve të jashtme në vlerë prej 25,790€. Megjithëse, pavarësisht rritjes së buxhetit niveli i shpenzimit ishte shumë i ulët, në vetëm 18%.

Çështja 2 – Nivel shumë i ulët i realizimit të buxhetit për investime kapitale

- E gjetura** Ekzekutimi i buxhetit ishte nën nivelin e pritshëm, ndërsa shpenzimi i të hyrave vetanake ishte jo adekuat. Performanca e dobët buxhetore kryesisht vërehet te investimet kapitale në vetëm 18%. Edhe me shqetësuese është fakti se nga vlera totale e realizimit për këtë kategori, mbi 34% (22,414€) ishte bërë më vendime gjyqësore për pagesën e pagave dhe mallrave dhe shërbimeve (shih kapitullin 2.1). Niveli i ulët i realizimit ishte për shkak të vonësës në fillimin e procedurave të prokurimit dhe dobësive në hartimin e dokumentacionit të projektit/ menaxhimit të projekteve. Kjo është sfida kryesore me të cilën ballafaqohet komuna. Kjo çështje nuk është adresuar nga menaxhmenti në vitet e fundit, edhe pse është trajtuar në raportet e mëparshme të auditimit.
- E gjetura** Planifikimi joadekuat i buxhetit dhe ekzekutimi i tij i dobët do të rezultojë në mos përmbushjen e qëllimeve të organizatës, zvogëlimin e Grantit të qeverisë dhe humbjen e kredibilitetit para qytetarëve dhe donatorëve potencialë.
- Rekomandimi 2** Kryetari duhet të zbatojë një vlerësim sistematik të shkaqeve të ekzekutimit të ulët të buxhetit për investimet kapitale dhe të marrë parasysh mundësitë për fillim të hershëm të procedurave të prokurimit për të parandaluar sfidat që paraqiten gjatë planifikimit dhe ekzekutimit të aktiviteteve të prokurimit.

3.2 Të hyrat

Në vitin 2017, komuna ka tejkuluar planin fillestar për inkasimin e të hyrave për 7%. Pjesa më e madhe e të hyrave ishte realizuar nga tatimi në pronë (39%), tarifatat lidhur me shërbimet e ofruara komunale, tarifatat lidhur me token. Përveç kësaj, komuna ka pranuar të hyrat indirekte në shume prej 5,330€ nga gjobat e policisë.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Pranimet	2016 Pranimet	2015 Pranimet
Të hyrat vetjake viti vijues	104,297	104,297	111,605	118,120	90,320

Vlen të theksohet se gjatë vitit 2017 është kryer transferi i të hyrave vetjake të realizuara në periudhën 2014 - 2016 në vlerë 156,153€.

Çështja 3 – Dobësitë në menaxhimin e të hyrave

- E gjetura** Kemi identifikuar një varg dobësish sistematike lidhur me planifikimin, inkasimin dhe raportimin e të hyrave. Komuna nuk ka zbatuar rregulloret ligjore për inkasimin e të hyrave. Si rezultat i kësaj janë paraqitur këto dobësi:
- Komuna kishte tejkeluar të hyrat e realizuara për 7% në raport me planifikimin, mirëpo ne me mbikëqyrjen e hollësishme të planifikimit kemi hasur në devijime dhe ndryshime të mëdha në realizimin e të hyrave vetjake në raport me ato të planifikuara fillimisht. Të hyrat e mbledhura kanë tejkeluar vlerën e planifikuar për to për shkak të rritjes së të hyrave nga qiraja për objektet, si dhe pranimeve të të hyrave nga taksat komunale që nuk ishin parashikuar në kuadër të planit për vitin 2017. Megjithëse komuna e ka tejkeluar planin, të hyrat nga tatimi në pronë, si pozicioni më i madhe i të hyrave ishte realizuar në nivelin 53% të shumës së planifikuar;
 - Komuna nuk ka inkasant, prandaj grumbullimi i të hyrave bëhet në para të gatshme nga zyrtarët në departamente të ndryshme të komunës (financa, kadastër, administratë). Zyrtarët e pranojnë para apo taksa vlera e të cilave tejkalon 10€; dhe
 - Komuna nuk ka arritur ta bëjë verifikimin e 1/3 të pronave të regjistruar për tatim mbi pronë. Komuna nuk kishte plan dhe nuk ka raport mbi verifikimin e objekteve sipas kërkesave ligjore.
- Rreziku** Planifikimi i të hyrave është nënvlerësuar, gjë që ndikon në paraqitjen e pasaktë të tyre në PFV. Pranimi i parave të gatshme në shuma mbi 10€ është në kundërshtim me Rregullat e Thesarit dhe rrezikon që paraja të keqpërdoret ose të humbet. Mos përmbushja e kërkesave ligjore të verifikimit të 1/3 të pronës ndikon në zvogëlimin e normës së grumbullimit të tatimit në pronë.
- Rekomandimi 3** Kryetari duhet të sigurojë që planifikimi i të hyrave të bazohet në objektivitet. Është e domosdoshme të vendoset komunikimi dhe shkëmbimi i dokumenteve dhe të dhënave ndërmjet departamenteve të ndryshme të përfshira në proces, nga përcaktimi i tarifës, evidentimi, e deri te inkasimi dhe kontrolli i inkasimit të të hyrave. Pagesa mbi 10€ kërkohet të bëhet përmes një llogarie bankare. Shumat e mbledhura të të hyrave duhet të deponohen në bankë brenda afatit të përcaktuar ligjor. Po ashtu komuna duhet të ketë një plan për kontrollin e 1/3 të pronës brenda juridiksionit të saj.

Çështja 4 – Mungesa e kontrollit të inkasimi dhe deponimi i të hyrave nga mbeturinat komunale**E gjetura**

Deri në vitin 2017, komuna ka pasur marrëveshje bashkëpunimi me kompaninë “Ecohigjena” për grumbullimin e mbeturinave nga territori i komunës së Klllokotit. Pas përfundimit të marrëveshjes, komuna vazhdon në mënyrë të pavarur t’i ofroj shërbimet, në kuadër të të cilave hyjnë grumbullimi dhe transportimi i mbeturinave komunale dhe përcaktimi i procedurave të pagesës. Inkasantët e deleguar nga ana e komunës, pranojnë kompensimin sipas faturave mujore në para të gatshme nga qytetarët. Të hyrat e inkasuara deponohen në xhirollogari të komunës dhe regjistrohen si të hyra vetjake në kodin (50401). Duke shqyrtuar dokumentacionin e bashkëngjitur, kemi konstatuar si në vijim:

- Komuna nuk posedon vendim të kuvendit komunal për shërbimet e grumbullimit, transportit dhe deponimit të mbeturinave e as rregullore mbi lartësinë e kompensimit për shërbimet e ofruara. Faturimi bëhet në bazë të deklaratave të inkasantëve, në bazë të lartësisë së kompensimit që ka qenë e caktuar nga ana e kompanisë “Ecohigjena” në shumë prej 5€. Është vërejtur edhe ekzistimi i faturave /dëftesave në shuma të cilat nuk janë të përcaktuara me këtë çmimore (dëftesa: 0014244 në vlerë prej 3.50€; 0014219 pa vlerë; 0014231 në vlerë prej 8€);
- Inkasantët nuk kanë qasje në bazën e shfrytëzuesve, gjegjësisht nuk posedojnë evidenca të besueshme dhe regjistra të të gjithë obliguesve dhe subjekteve ekonomike nga të cilat kryhet pagesa e taksave. Sipas deklaratave të tyre, bazën e të dhënave e ka mbajtur “Ecohigjena”;
- Faturimi për personat fizikë bëhet në bllok/Paragon, me të cilët inkasantët ngarkohen në Departamentin e shërbimeve komunale të cilat nuk janë të lidhura me numër rendor. Faturimi për subjekte ekonomike bëhet në bllok UNIREF, mirëpo ne nuk janë ofruar dëshmitë nga komuna lidhur me to; dhe
- Nuk bëhen harmonizime të rregullta me zyrtarin e të hyrave, dhe pagesat nuk bëhen në baza mujore.

Rreziku

Mos azhurnimi i tarifave mund të ndikojë në klasifikim jo adekuat dhe llogaritje të gabuar të taksave. Mungesa e kontrollit nëpërmjet mos evidentimit të të gjithë personave të ngarkuar, mungesa e një baze të dhënash mbi pagesat e bëra dhe borxhet e prapambetura, ka për pasojë inkasimin e pamjaftueshëm të të hyrave dhe në të njëjtën kohë humbjen e kredibilitetit të institucionit.

Rekomandimi 4 Kryetari duhet të sigurojë azhurnimin e tarifave të të gjitha taksave të cilat paguhen në emër të kryerjes së shërbimeve. Nevojitet evidentimi i të gjithë personave të cilët deri më tani nuk i kanë shlyer borxhet për shërbimet e bartjes së mbeturinave, dhe futjes në sistemin e pagesës. Shtimi i kontrollit të pagesës nëpërmjet faturimit të saktë, evidentimit dhe harmonizimit të rregullt të shumës së inkasuar dhe deponuar në baza mujore.

3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga Ministria e Administratës Publike dhe MF, i cili nuk është i integruar me bazën e të dhënave personale, por megjithatë siguron një sistem efikas kontrolli dhe pagesash që korrespondon me nivelin komunal. Kontrollat e kryera nga komuna kanë të bëjnë me llogaritjen e pagave në pajtim me kontratat e punonjësve dhe ligjet në fuqi. Komuna i përditëson pagat në baza mujore para se të ekzekutohet lista e pagave, ndërsa ndryshimet bëhen me kohë.

Numri i punonjësve të miratuar nga komuna është 124, dhe i njëjti është plotësuar nga ana e komunës. Ne kemi testuar disa procedura të rekrutimit, dosjet e personelit, kemi shqyrtuar listat e pagave dhe kemi krahasuar informacionet e paraqitura me SIMFK dhe prezantimin e tyre në PFV.

Çështja 5 – Angazhimet në bazë të marrëveshjeve për shërbime të veçanta

E gjetura Komuna vazhdon të angazhojë stafin përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta, të cilat angazhohen pa procedura të rregullta të rekrutimit. Gjatë vitit 2017 janë angazhuar 10 punëtorë për pozita të karrierës.

Rreziku Angazhimi i punonjësve me kontrata për shërbime të veçanta duke shmangur procedurat e hapura të rekrutimit, minimizon konkurrencën dhe rrit rrezikun e angazhimit të personave jo adekuat në pozita të caktuara.

Rekomandimi 5 Kryetari duhet të sigurojë se punonjësit përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta angazhohen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike. Angazhimi të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore përmes një procesi konkurrues dhe transparent. Nëse ekziston nevoja për rritjen e numrit të stafit (pozita të karrierës), punëtorët duhet paraparë në planifikimin buxhetor dhe duhet bërë angazhimin e tyre përmes një procesi të hapur të rekrutimit.

3.4 Menaxhimi i personelit

Menaxhimi i personelit ka për qëllim koordinimin e aktiviteteve të organizatës për të siguruar funksionimin e sistemit në përputhje me politikat e administratës komunale dhe të kuvendit komunal, të cilat zbatohen në gjithë organizatën. Kjo përfshinë: Hartimin dhe rishikimin e strukturës organizative, kategorizimin dhe përshkrimin e vendeve të punës, kontrollin e kostove buxhetore të personelit, si dhe kontrollin e procesit të rekrutimit, trajnimit dhe zhvillimit të personelit, duke përfshirë këtu edhe matjen e efektivitetit të personelit përmes vlerësimit të performancës së kryerjes së detyrave.

Çështja 6 - Dosjet e pa kompletuara të stafit

- E gjetura** Nga shqyrtimi i 34 dosjeve të personelit, kemi identifikuar se asnjë nga dosjet e shqyrtuara nuk ishin të kompletuara, gjegjësisht nuk janë në përputhje me kërkesat e Udhëzimit Administrativ 03/2011 (UA). Mungesat si: çertifikata se punonjësit nuk janë nën hetime, si dhe përshkrimet e vendeve të punës mungonin në 33 dosje të shqyrtuara.
- Rreziku** Nuk ka të dhëna të disponueshme për të justifikuar pagat/shtesat dhe lejojnë shqyrtimin e rezultateve të vlerësimit të ndikimit.
- Rekomandimi 6** Kryetari duhet të sigurojë se është ndërmarrë një rishikim sistematik i dosjeve të personelit, për të siguruar se i tërë dokumentacioni i nevojshëm është përfshirë brenda një periudhe specifike kohore.

Çështja 7 - Parregullsitë në rekrutimin e stafit

- E gjetura** Departamenti komunal i Arsimit më datë 29/08/2017 kishte hapur konkurs, për plotësimin e vendeve të punës për stafin mësimdhënës për vitin shkollor 2017/2018. Konkursi është hapur për pranimin e arsimtarëve në tri shkolla fillore dhe një të mesme, me kriteret të cilat janë përcaktuar në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 06 /2015.
- Në bazë të konkursit mungojnë të dhënat lidhur me numrin e vendeve të kërkuara të punës, si dhe normën e orëve të përcaktuara për secilën pozitë. Me tutje mungonte vendimi për themelimin e komisionit për zgjedhjen e personelit arsimor.
- Konkursi në Sektorin e shëndetit primar, është shpallur për pesë pozita. Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar, që është pa datë dhe vulë, nuk ishim në gjendje të përcaktojmë se për çfarë periudhe është shpallur konkursi.

-
- Rreziku** Mosrespektimi i ligshmërisë së procesit të rekrutimit rrezikon të drejtën për trajtim të barabartë dhe krijon pabarazi mes konkurrentëve dhe, nga ana tjetër, krijon favorizime.
- Rekomandimi 7** Është e nevojshme të merren të gjitha masat në mënyrë që në të ardhmen shpallja e konkursit të bëhet në përputhje me dispozitat ligjore dhe të gjithë kandidatët të kenë mundësi të barabarta për punësim në institucionet arsimore.

3.5 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2017 ishte 175,734€. Prej tyre ishin shpenzuar 141,013€. Këto shpenzime kanë të bëjnë me shpenzimet për karburante, shpenzimet për dreka zyrtare, shpenzime telefonike. Rritja e shpenzimeve krahasuar me vitin 2016 është vërejtur në kodet e shërbimeve të tjera të kontraktuara.

Çështja 8 – Pagesa nga kodi i gabuar

- E gjetura** Komuna e ka bërë pagesën në bazë të kontratës “Furnizimi me pajisje të TI për nevojat e Komunës” në vlerë prej 5,320€ nga kodi 13460 (shpenzimet tjera), derisa kodi adekuat për regjistrimin e tyre ishte 13503 (pajisje kompjuterike).
- Rreziku** Mos regjistrimi i shpenzimeve në kode relevante është rezultat i kodifikimit të gabuar të shpenzimeve më rrezik që pasqyrat financiare të mos i prezantojnë drejtë shpenzimet.
- Rekomandimi 8** Kryetari duhet të sigurojë që zyrtari për shpenzime ta bëjë regjistrimin e drejtë të shpenzimeve sipas kodeve përkatëse, në përputhje të plotë me planin kontabël.

3.6 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 27,994€. Shpenzimet e këtyre mjeteve ishin në nivelin 100%. Nga kjo kategori ne testuam shtatë pagesa dhe ne shqyrtuam nëse ato ishin dhënë në përputhje me rregullat.

Çështja 9 - Mos përcaktimi i kufijve për ndarjen e subvencioneve

E gjetura Rregullorja e brendshme për ndarjen e subvencioneve, neni 9, nuk tregon vlerën monetare të lejuar nga ana e komunës për ndarjen e subvencioneve.

Me tutje, me rastin e shqyrtimit të shtatë rasteve të dhënies së ndihmës financiare nga ana e komunës, kemi konstatuar se kontrollet e brendshme nuk ishin funksionale. Përkatësisht, kemi hasur në mungesë të informatave kthyesë nga ana e përfituesve të subvencioneve, gjë që është në kundërshtim me nenin 10 të Rregullores së Brendshme të Subvencioneve.

Rreziku Mos përcaktimi i vlerës monetare të lejuar, mund të rezultojë në mos informimin e saktë të shfrytëzuesve potencialë me rastin e shprehjes së interesit për aplikimin për dhënie të drejtës për subvencione. Mungesa e informatave kthyesë mbi shpenzimin e fondeve të alokuara krijon rrezikun që fondet të mos shpenzohen për qëllimet për të cilat janë ndarë.

Rekomandimi 9 Kryetari duhet të sigurojë ndërmarrjen e masave të nevojshme për azhurnimin e rregullores për ndarjen e subvencioneve, të përcaktojë limitet e lejuara me qëllim të rritjes së transparencës dhe informimit të saktë të opinionit. Duhet të forcohen kontrollet e brendshme, në mënyrë që mjetet e ndara nga ana e komunës në emër të subvencioneve të arrijnë qëllimin e synuar.

3.7 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 352,793€. Prej tyre në vitin 2017 ishin shpenzuar 65,007€, nga të cilat 22,414€ ishin shpenzuar më vendime gjyqësore, ndërsa pjesën tjetër e përbëjnë shpenzimet për renovimin e shkollës dhe ndërtimin e trotuarit.

Çështja 10 - Dobësi në procedurat e prokurimit dhe menaxhimin e projekteve

E gjetura Komuna ka nënshkruar kontratën "Rehabilitimi i shkollës fillore në fshatin Mogillë" me vlerë prej 33,555€, ku periudha e mbulimit të sigurimit të ekzekutimit është më e shkurtër se kërkesa e specifikuar në dosjen e tenderit. Sipas kësaj kontrate, një situacion është paguar në shumën prej 16,804€, para se të përgatitej raporti nga organit mbikëqyrës. Shuma e mbetur e punëve nuk është mbuluar me sigurim të ekzekutimit, i cili ka skaduar më 18/01/2018.

Rreziku Dobësitë e identifikuar rezultojnë me respektim të pjesëshëm të procedurave të përcaktuara në Ligjin mbi Prokurimin Publik (LPP) dhe kontrollet e dobëta për nisjen, menaxhimin dhe ekzekutimin e projekteve. Sigurimi i zbatimit për një periudhë më të shkurtër se sa kërkohet, nuk ofron siguri të mjaftueshme për komunën se punimet do të përfundojnë. Pagesa e situacionit para marrjes së raportit të organit mbikëqyrës rrit rrezikun që të paguhet puna që nuk është kryer.

Rekomandimi 10 Kryetari duhet të sigurojë që kryerja e procedurave të prokurimit t'u nënshtrohet kontrolleve të rrepta, që nga inicimi i proceseve e deri te ekzekutimi i kontratës. Gjithashtu, duhet të sigurojë që të zbatohen të gjitha kontrollet e rregullsisë së dokumentacionit, dhe pagesat të bëhen vetëm pasi të plotësohen kërkesat e rregullave financiare për shpenzimin e parasë publike.

3.8 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale:

Çështja 11 - Menaxhimi i dobët i kontratave

- E gjetura** Komuna ka vazhduar kontratën për "Shërbimet e sigurisë fizike të ndërtesës së komunës" duke nënshkruar kontratën më 01/08/2017 për shërbime të përkohshme, për shkak të vonesës në procedurat e reja të prokurimit. Më pas, komuna nënshkroi një kontratë për "Shërbimet e sigurisë fizike të ndërtesës" më 19/09/2017, për një periudhë prej 37 muajsh (sipas LPP-së, maksimumi i kohëzgjatjes së kontratave duhet të jetë 36 muaj). Në dosjen e tenderit, Pjesa II. Përshkrimi i çmimit, çmimi i ofruar për njësi (punonjës) në vlerë prej 310€, e llogaritur për nëntë punëtorë në nivel mujor prej 2,790€, ndërsa faturimi është bërë duke u bazuar në orë punë. Përveç kësaj, licenca e kërkuar në dosjen e tenderit për "Shërbimet themelore të sigurimit" është me afat vlefshmërie deri më 12/06/2018, dhe nuk mbulon periudhën e kontraktuar të ofrimit të shërbimeve. Raportet e Menaxherit të kontratës nuk specifikojnë ekzekutimin e saktë të shërbimit të marrë.
- Rreziku** Dobësitë në menaxhimin e kontratave, gjegjësisht mungesa e raportimit cilësor në lidhje me zbatimin e kontratës, zvogëlojnë sigurinë që kontratat të zbatohen në përputhje me kushtet dhe specifikimet e parapara. Periudha e kontraktimit është në kundërshtim me LPP.
- Rekomandimi 11** Kryetari duhet të sigurojë një respektim të qëndrueshëm dhe efektiv të rregullave/procedurave të prokurimit, si dhe menaxhimin adekuat të kontratave për të siguruar arritjen e vlerës për paratë e shpenzuara për prokurim. Mbikëqyrja sistematike e zbatimit të kontratës do të rrishte sigurinë për zbatimin e tyre në përputhje me kushtet e kontraktuara.

3.9 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Menaxhimi i pronës është një pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Kjo kërkon procedura kontrolli dhe menaxhimi që konfirmojnë ekzistencën e pronës dhe sigurojnë të dhëna të sakta dhe të përditësuara në lidhje me pasuritë e institucionit.

Prezantimi i pronës komunale është kërkesë e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi. Komuna duhet të prezantojë të gjitha pasuritë që zotëron në fund të periudhës raportuese. Raportet e pasurisë që do të prezantohen nga komuna janë: Pasqyra e pasurive jo financiare, pasuritë jo-kapitale dhe pasqyrat e stoqeve.

Komuna ende nuk ka arritur të ofrojë një regjistër të përgjithshëm dhe të plotë të pasurisë jo-financiare. Sfidat e regjistrimit dhe vlerësimit të pasurive kanë rezultuar me një nënvlerësim material të vlerës së pasurisë në PFV, veçanërisht ato që lidhen me tokën dhe investimet kapitale.

Ne testuam gjendjen fillestare, blerjet gjatë vitit të pasurisë duke përfshirë investimet kapitale, si dhe blerjet e pajisjeve në mobilje në shumën nën 1,000€ nga mallrat dhe shërbimet, si dhe korrigjimin në regjistrimin e pronës që është në dispozicion. Ne gjithashtu kryem një ekzaminim fizik në mënyrë që të konfirmojmë ekzistimin e pronës.

Çështja 12 - Dobësitë në menaxhimin e pasurisë

E gjetura Komuna ende nuk ka procedurë të brendshme për menaxhimin e pasurisë në përputhje me kërkesat e Rregullores së Thesarit 02/2013. Nuk është themeluar Komisioni për vlerësimin e pasurive.

Gjithashtu, kemi vërejtur se pasuritë nën 1,000€ nuk janë regjistruar në e/pasuri sepse ky sistem nuk ka qenë në përdorim as gjatë vitit 2017 e as në vitet paraprake.

Rreziku Mungesa e procedurave të brendshme për menaxhimin e pasurisë, rrit rrezikun që komuna të mos ketë kontroll mbi të gjithë pronën dhe të mos jetë në gjendje të gjenerojë raporte të sakta lidhur me pasurinë. Në mungesë të raporteve mbi gjendjen e pasurisë, ekziston rreziku i keqpërdorimit ose humbjes së tyre.

Rekomandimi 12 Kryetari duhet të iniciojë procesin e hartimit të rregulloreve të brendshme në lidhje me regjistrimin e pasurisë (tokat dhe objektet), dhe të sigurojë që janë zbatuar të gjitha kërkesat në lidhje me vlerësimin e pasurisë komunale në fund të vitit. Në fund të vitit, para hartimit të pasqyrave financiare duhet të kryhet edhe procesi i inventarizimit i cili duhet të harmonizohet me regjistrat e pasurisë.

3.10 Trajtimi i parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj

Paratë e gatshme janë fond i vogël i parave të cilat mbahen nën kontroll të organizatës buxhetore, dhe shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve për blerje të ndryshme me vlerë të vogël deri në 100€.

Çështja 13 - Vonesat në përmbyllje të avanseve

E gjetura Organizata buxhetore nuk ka caktuar një arkëtar zyrtar për para të imëta në bazë të Rregullës Financiare 01/2010 mbi kontrollin e brendshëm dhe Rregullën Financiare 01/2013 mbi Shpenzimin e parave publike.

Avanset e pa mbyllura të raportuara në PFV ishin në vlerë prej 8,500€, derisa sipas të dhënave të thesarit avanset janë në vlerë 10,928€, më diferencë 2,428€. Për me tepër komuna nuk ka kontrolle në menaxhimin e tyre, përkatësisht ekzistojnë vonesa të konsiderueshme për mbylljen e tyre. Nga vlera totale e avanseve, 6,500€ janë të pambyllura që nga viti 2016.

Rreziku Vonesa në përmbylljen e avanseve rrit rrezikun e mos kthimit të mjeteve financiare. Gjithashtu, kjo krijon shqetësim lidhur me atë se këto fonde a janë shpenzuar në mënyrë efikase dhe për qëllimin e pritur.

Rekomandimi 13 Kryetari duhet të sigurojë se avanset arsyetohen brenda afatit të përcaktuar në Rregulloren 2004/07. Formularëve për mbylljen e avanseve duhet bashkangjitur të gjitha faturat, kërkesat dhe lista e pranimeve. Nëse ka një kthim të parave nga avansi për udhëtim zyrtar, shuma tjetër e pashpenzuar kthehet në llogarinë e bankës komerciale.

3.11 Të arkëtueshmet

Të arkëtueshmetë këtë vit tregojnë trendin e rritjes së këtyre llogarive për shkak se komuna ka paraqitur të arkëtueshme në vlerë prej 487,619€, krahasuar me 472,646€ sa ishin në vitin paraprak. Kjo ndodh për shkak të politikave joefektive që janë zbatuar nga menaxhmenti dhe mungesës të një strategjie për mbledhjen e tyre.

Sistemi i regjistrimit të tatimpaguesve është i centralizuar në një bazë të dhënash të pronës tatimore që përmban informacion për të gjitha komunat në Kosovë dhe mirëmbahet nga Departamenti i Taksave të Pronës në Ministrinë e financave (MF). Secila komunë është e detyruar të menaxhojë futjen e informacionit të tatimit në pronë në bazën e të dhënave, me të gjitha informatat, përfshirë tatimin në pronë, adresat e pronës, adresat e pronarëve dhe përdoruesve, të dhënat e tokës dhe ndërtesave, vlerat e pronës, shkallen e tatimit, detyrimet tatimore dhe të dhënat e pagesave tatimore.

14 - Menaxhimi i llogarive të arkëtueshme

E gjetura Megjithëse komuna po bën një përpjekje të vazhdueshme për të mbledhur te arkëtueshmetë e tatimit në pronë, që deri më tani kanë arritur në vlerë 363,559€, sipas të dhënave të Departamentit të Tatimit në Pronë MF, aftësia për mbledhjen e tatimeve në fund të vitit 2017 ishte 44,012€ apo vetëm 12%. Përkundër problemeve me të arkëtueshmetë e vjetra të tatimit në pronë, ato janë evidente edhe në një nivel vjetor për shkak të rënies së inkasimit gjatë vitit 2017 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016.

Të arkëtueshmetë nga faturimet për menaxhimin e mbeturinave komunale nuk janë raportuar në PFV pasi që komuna nuk ka një bazë të të dhënave për përdoruesit.

Gjithashtu, të arkëtueshmetë në emër të taksave të biznesit janë në rritje drastike madje deri 67% më shumë krahasuar me vitin 2016.

Rreziku Mungesa e mekanizmave dhe kontrolleve adekuate rrit rrezikun e rritjes së vazhdueshme të këtyre llogarive, duke rezultuar në fonde më të vogla për arritjen e qëllimeve dhe inkurajon debitorët tjerë që të mos paguajnë detyrimet e tyre.

Rekomandimi 14 Kryetari duhet të analizojë arsyet për trendin në rritje të llogarive të arkëtueshme të tatimit në pronë dhe të forcoj kontrollet për të parandaluar rritjen e tyre të mëtejshme. Duhet të krijohet një strategji dhe mekanizëm për të mundësuar identifikimin dhe grumbullimin e borxheve të akumuluarra përmes futjes së kushtëzimit të disa shërbimeve komunale bazuar në evidencën e tatimit në pronë të paguar. Gjithashtu, është e nevojshme që komuna të menaxhojë siç duhet llogaritë e arkëtueshme në emër të taksës për biznesin.

3.12 Obligimet e papaguara

Obligimet komunale paraqesin detyrime ndaj furnizuesve, të cilat janë bartur për pagesë në periudhën në vijim.

Komuna ka detyrime kontingjente në lidhje me raste të ndryshme gjyqësore, në vlerë prej 97,665€, të cilat janë të prezantuara në kuadër të Raportit për obligimet e pa paguara (Ref. kapitulli 2.2).

Çështja 15 – Dobësi në menaxhimin dhe raportimin e obligimeve

E gjetura Shuma e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 198,158€, nga të cilat vetëm 5,362€ rrjedhin nga faturat e papaguara të vitit 2017, ndërsa komplet pjesa tjetër prej 192,796 € përbën obligimet e bartura nga vitet 2011 - 2013. Këto detyrime janë bartur për pagesë në vitin 2018 dhe kanë të bëjnë me shpenzimet për mallra dhe shërbime, shërbime komunale dhe investime kapitale. Krahasuar me vitin paraprak, ka pasur një trend të rënies së obligimeve për 24,390€.

Dobësitë në menaxhimin dhe raportimin e obligimeve vijnë si pasojë e mungesës së një sistemi të evidentimit dhe menaxhimit të faturave të pranuar deri në pagesën e tyre, gjë që shkakton vështirësi në menaxhimin e tyre.

Rreziku Obligimet financiare të pambuluara mund të dobësojnë aftësinë për të planifikuar dhe menaxhuar nevojat për likuidim dhe komuna mund të përballet me shpenzime shtesë të ndëshkimeve për vonesat ndaj palëve. Niveli i lartë i obligimeve të papaguara rrit rrezikun që buxheti të jetë subjekt i zbatimit të drejtpërdrejtë nga thesari dhe vendimeve të gjykatës.

Rekomandimi 15 Kryetari duhet të sigurojë një shqyrtim kritik të gjendjes së obligimeve të papaguara, me qëllim të përcaktimit të prioritetit të pagesës, që të shmangen rrethanat që mund të shkaktojnë pagesën e tyre të drejtpërdrejtë nga ana e thesari ose në bazë të vendime gjyqësore. Në koordinim me Përfaqësuesin Ligjor të Komunës, detyrimet kontingjente duhet të identifikohen qartë dhe të ndahen nga detyrimet reale, në mënyrë që prezantimi i tyre në PFV të jetë i saktë. Është e nevojshme që të zbatohet plotësisht sistemi i evidentimit dhe raportimit të obligimeve të papaguara.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Auditimi i PFV-ve të Komunës së Kllokotit për vitin 2016 ka rezultuar me 20 rekomandime. Komuna nuk ka hartuar dhe dorëzuar një Plan Veprimi. Gjithashtu, raporti i Auditimit të jashtëm nuk ishte prezantuar në kuvendin komunal gjatë vitit 2017.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, vetëm një rekomandim është zbatuar; një është në proces të zbatimit, ndërsa 18 nuk janë zbatuar ende. Nga viti 2015 janë bartur 13 rekomandime, prej të cilave dy janë zbatuar, dy janë në proces dhe nëntë nuk janë zbatuar. Shihni Shtojcën II.

Çështja 16 - Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm

E gjetura Për shkak të menaxhimit të dobët të procesit dhe mungesës së një monitorimi formal për mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të AP, vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar dhe atyre të bartura më herët janë zbatuar. Ne nuk kemi vërejtur se komuna aplikon masa përgjegjësie për moszbatimin e rekomandimeve.

Rreziku Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të menaxhmentit dhe kontrolleve tjera në sistemet financiare kyçe, me theksim të veçantë në:

- Gabimet materiale në PFV;
- Regjistrin jo të plotë të pasurisë;
- Procese të dobëta të planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit; dhe
- Dobësi të deponimi i të hyrave vetanake të grumbulluara;

Rekomandimi 16 Kryetari dhe këshilltarët komunalë duhet të sigurojnë që zbatimi i planit të veprimit, monitorohet në vazhdimësi dhe raportohet në baza të rregullta mujore ose tre mujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër nga kryetari, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontroleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA-së me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-së nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i pyetësorëve të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda komunës veçanërisht në lidhje me kualitetin e raportit menaxherial dhe menaxhimin e rrezikut. Pyetësori i vetëvlerësimit, i cili plotësohet nga komuna, e reflekton këtë situatë vetëm pjesërisht, me disa komente pozitive mbi ekzistencën e formave aktuale të qeverisjes që nuk mbështeten në prova.

Përgjigja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit dhe operimi i një sistemi cilësor të auditimit të brendshëm, nuk janë të vendosura. Njësia e Auditimit të Brendshëm dhe Komiteti i Auditimit nuk janë themeluar.

Komuna nuk plan strategjik dhe nuk bën një analizë për matjen e rezultateve të arritura të qëllimeve të përcaktuara në strategjinë e zhvillimit të komunës. Gjithashtu komuna ka planin zhvillimor komunal të përbashkët me komunën e Vitisë 2010/2020.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Në bazë të Ligjit nr. 02/L-74 për Auditimin e Brendshëm, çdo organizatë buxhetore duhet të themelojë Njësinë e Auditimit të Brendshëm (NjAB) dhe të sigurojë që aktivitetet, të dhënat dhe sistemet e saj të menaxhimit dhe kontrollit, të paktën një herë në vit, i nënshtrohen një kontrolli të brendshëm gjithëpërfshirës. Një sistem adekuat i auditimit të brendshëm ndihmon menaxhmentin në identifikimin e dobësive në menaxhimin financiar dhe kontrollin e komunës. Kjo i shton vlerën parave të shpenzuara dhe kontribuon në arritjen e qëllimeve dhe përmirësimin e shërbimeve të ofruara nga komuna.

Çështja 17 - Dobësitë në auditimin e brendshëm

- E gjetura** Komuna gjatë vitit 2017 nuk ka siguruar shërbime të auditimit të brendshëm, e as nuk e ka formuar komitetin e auditimit, edhe pse vazhdimisht i është rekomanduar nga ana e AP-së. Kjo ka ndodhur sepse menaxhmenti komunal nuk ka arritur ta kuptojë rolin dhe rëndësinë e auditimit të brendshëm në përmirësimin e aktiviteteve komunale.
- Rreziku** Mungesa e një shqyrtimi të vazhdueshëm të auditimit të brendshëm mund të ndikojë në vazhdimin e përsëritjes së dobësive në sistemet kryesore të kontrollit të brendshëm. Për më tepër, menaxhmenti mund të mos jetë në gjendje që me kohë të identifikojë dobësitë e kontrolleve dhe të reagojë më eliminimin e tyre.
- Rekomandimi 17** Kryetari duhet ta shqyrtojë rekrutimin e një auditori të brendshëm, i cili përmes një programi gjithëpërfshirës të punës do t'i klasifikojë rreziqet financiare dhe të tjera të komunës dhe i cili do të vlerësonte efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Përveç kësaj, ne gjithashtu propozojmë krijimin e një Komiteti efektiv të Auditimit që do të shqyrtojë në mënyrë kritike planet dhe rezultatet e auditimit të brendshëm.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Rishikimi ynë i kontrolleve menaxhuese vuri në dukje raportimin e dobët financiar të menaxhimit dhe shpenzimeve, si dhe analizën e pa kompletuar të ofrimit të shërbimeve. Duke pasur parasysh se komuna ka probleme me saktësinë e listës së pronave, çështje kjo që është ngritur vazhdimisht në raportet e auditimit të jashtëm, Kuvendi i Komunës duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë raportit të pronës. Ai duhet t'i kërkojë ekzekutivit të ofrojë lista të azhurnuara të pronës komunale dhe t'i kërkojë komunës të përfshijë burime shtesë për regjistrimin, kontrollin dhe vlerësimin e pronës komunale dhe për të siguruar që regjistrimi dhe paraqitja e pasurisë në pasqyrat financiare të kryhet në mënyrë të vazhdueshme.

Nga ana tjetër, komuna duhet të mbajë regjistrat e të hyrave të mbledhura dhe shumat e llogarive të pa arkëtuara. Çështje po aq e rëndësishme është mos raportimi në baza javore ose mujore te Kryetari, si dhe ndarja e detyrave për stafin, ku një zyrtar është përgjegjës për më shumë se një detyrë, dhe kjo ndodh për shkak të mungesës së stafit.

Çështja 18 - Mos zbatim i kërkesës për menaxhimin e rrezikut

- E gjetura** Komuna nuk ka vendosur procedura zyrtare të menaxhimit të rrezikut, që përfshin identifikimin, vlerësimin, reagimin dhe kontrollimin e ngjarjeve ose situatave që mund të kenë ndikim negativ në përmbushjen e objektivave të shfrytëzuesve të parisë publike. Nuk janë ndërmarrë hapat fillestar e as përgjegjësia për trajtimin e rreziqeve të mundshme për organizatën.
- Rreziku** Mungesa e menaxhimit efektiv të rrezikut do të zvogëlojë kontrollin mbi ngjarjet dhe situatat potenciale që mund të kenë efekt negativ në arritjen e objektivave të shfrytëzuesve të parisë publike. Veprimet pro-aktive që janë të nevojshme për shmangien eventuale të ndikimit të këtyre çështjeve, nuk do të ndërmerren në një mënyrë të planifikuar dhe sistematike.
- Rekomandimi 18** Kryetari duhet të sigurojë vlerësimin e rrezikut përmes identifikimit të objektivave kryesorë, zonave potencialisht problematike dhe masave për zvogëlimin e rrezikut në një nivel të pranueshëm. Nevojitet përgjegjësia e drejtpërdrejtë e deleguar për menaxhimin e rrezikut në një nga drejtorët përkatës i cili, në koordinim me menaxherët e njësive, do të menaxhojë këtë proces dhe do të raportojë mbi menaxhimin e rrezikut në baza mujore.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinionin të kualifikuar, opinionin të kundërt dhe mohimin të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keq deklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
1.4 Pajtueshmëria me kërkesat për PVF dhe kërkesat tjera për raportim	Kryetari duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF 2016 i adreson të gjitha çështjet e ngritura përfshirë rrezikun domethënës për pasuritë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PVF-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe tek fushat ku janë identifikuar gabime.		Përveç progresit në përgatitjen e PFV-ve, ende është në proces përfundimi i regjistrimit të pronës së gjithmbarshme komunale.	
2.3 Rekomandimet e vitit paraparak	Kryetari duhet të hartoj një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të këtij raporti dhe rekomandimeve të mëhershme dhe të forcoj masat e kontrollit dhe të përgjegjësisë ndaj personave të ngarkuar për adresimin të plotë rekomandimeve që veprimet e parashikuara me këtë plan veprimi të zbatohen, në veçanti në fushat e identifikuar me prioritet të lartë.	Po		
2.4 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit të MFK-së	Kryetari duhet të sigurojë se është zbatuar kërkesa për plotësimin e pyetësorit të vetëvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive dhe sistematike.	Po		

2.5.1 Vlerësimi i rrezikut	Kryetari duhet të sigurojë se është hartuar një listë ku rreziqet janë identifikuar sipas niveleve dhe gjasave që ato mund të ndodhin, si dhe janë parashikuar masat si kundërpërgjigje nëse ato ndodhin. Gjithashtu, përgjegjësia për menaxhimin e rrezikut duhet të delegohet tek një përgjegjës i cili do të raportoj tek menaxhmenti dhe të sigurojë zbatimin e kërkesave në këtë fushë.			Nuk janë marrë masa.
2.5.2 Plani strategjik i Komunës	Kryetari duhet të miratojë një plan të përgjithshëm strategjik për komunën i cili do të përcaktojë objektivat afatgjata dhe të shërbej si platformë orientuese për hartimin e planeve vjetore, kryerjen e analizave krahasuese mes viteve dhe matjen e rezultateve kundrejt objektivave.		Ky rekomandim është zbatuar pjesërisht sepse menaxhmenti i komunës nuk ka kryer një analizë për matjen e rezultateve të arritura të qëllimeve të përcaktuara në strategjinë e zhvillimit të komunës	
2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari i Komunës duhet të siguroj se shërbimi i auditimit të brendshëm, kryhet nga Ministria e Financave, apo ndonjë komunë tjetër. Shërbimi i auditimit, do të mbështeste menaxhmentin në vendimmarrje dhe eliminim të dobësive.			Nuk janë marrë masa.
3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit	Kryetari duhet të ndërmarrë një vlerësim të arsyeve për mos ekzekutim të buxhetit dhe të sigurojë një planifikim të mirëfilltë i cili bazohet në kërkesat reale si dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit.			Nuk janë marrë masa.

3.5.1 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Kryetari duhet të siguroj se kontratat për shërbime të veçanta përdoren vetëm për shërbime specifike aty ku me të vërtet ka mungesë të kuadrit si dhe kohëzgjatja e tyre mos të jetë mbi 120 ditë, siç e përcakton ligji. Në rast të vlerësimit për nevoja të angazhimeve afatgjata, duhet të shpallen procedura të rregullta rekrutimi.			Nuk janë marrë masa.
3.6 Të Hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)	Kryetari duhet të sigurojë se vlerësimet për pronat të kryhen me kohë dhe të vendosë kontrole të brendshme shtesë në fushën e mbledhjes, regjistrimit barazimit dhe raportimit të hyrave vetjake. Të ndërpres praktikat aktuale të inkasimit të pagesave mbi 10€ dhe këto pagesa të kryhen përmes llogarisë bankare. Ndërsa, pagesat e inkasuara nën këtë shumë, duhet të deponohen brenda 24 orësh në llogarinë bankare të autorizuar nga komuna.			Nuk janë marrë masa.
3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari duhet të siguroj marrjen e masave të menjëhershme dhe të inicioj regjistrimin e të gjitha pasurive në Sistemin E-pasuria. Nëse sistemi nuk mund të përdoret për arsye të ndryshme, regjistrimet të bëhen përmes ndonjë programi tjetër, i cili siguron plotësinë dhe saktësinë e regjistrimeve.			Nuk janë marrë masa.
3.7.2 Trajtimi i parasë së gatshme	Kryetari duhet të shtoj masat e kontrollit në zbatimin e rregulloreve të Thesarit dhe të siguroj se paraja e imtë do të shpenzohet në pajtim të plotë me procedurat e shpenzimeve. Blerjet që mund të parashihen me planin vjetor të prokurimit, nuk duhet të jenë subjekt i blerjeve me para të imta.			Nuk janë marrë masa.

3.7.3 Trajtimi i të arkëtueshmeve	Kryetari duhet ta shqyrtoj gjendjen e këtyre llogarive, të analizoj arsyet për akumulimin e këtyre shumave të konsiderueshme dhe të ndërmerr veprime efektive për maksimizimin e shkallës së inkasimit. Procesi i monitorimit sistematik të masave dhe politikave për rritjen e inkasimeve, duhet të jetë gjithashtu pjesë e shqyrtimeve të rregullta të menaxhmentit.			Nuk janë marrë masa.
3.7.4 Trajtimi i borxheve	Kryetari duhet të shqyrtoj në mënyrë kritike gjendjen e detyrimeve të papaguara, për të përcaktuar masat e nevojshme për adresimin e çështjeve të identifikuarra, dhe pagesat të bëhen në kuadër të limiteve kohore të përcaktuara me rregullat financiare. Një opsion i sugjeruar do të ishte që problemin e borxheve të prapambetura, komuna ta diskutoj edhe me Qeverinë.			Nuk janë marrë masa.
Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim	Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Kualifikim dhe Theksim të Çështjes. Duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i evituar gabimet në keq klasifikimin e shpenzimeve dhe në regjistrimin e plotë të pasurisë. Gjithashtu, duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2017 i adreson të gjitha çështjet e ngritura në raport dhe Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet, përveç nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.			Nuk janë marrë masa.

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	Kryetari duhet të sigurojë se do të zbatohet një proces i forcuar i llogaridhënies së stafit përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve, sipas afateve kohore dhe prioriteteve të përcaktuara me planin e veprimit. Monitorimi i progresit të rekomandimeve duhet të bëhet në mënyrë sistematike.			Nuk janë marrë masa.
2.2 Pyetësi i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së	Kryetari duhet të sigurojë se është ndërmarrë veprimi për plotësimin e listës kontrolluese të vetëvlerësimit dhe është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Më pas, duhet të aplikohet një mekanizëm për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.	Po		
2.3 Shqyrtimet specifike të menaxhimit	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se dot rishikohet plani strategjik i integruar dhe do të monitorohet në mënyrë sistematike arritja objektivave, duke vendosur funksione efektive të mbikëqyrjes dhe qeverisjes së mirë në nivel të organizatës. Nëse objektivat nuk janë të përshtatshme në planin e përmendur më lart, të sigurojë se është hartuar një plan i veçantë për komunën.		Ky rekomandim është zbatuar pjesërisht sepse menaxhmenti i komunës nuk ka kryer një analizë për të matur rezultatet e arritura të qëllimeve të përcaktuara me strategjinë e zhvillimit të komunës.	
2.3.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia	Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme brenda muajve në vijim.			Nuk janë marrë masa.

2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari të sigurojë shfrytëzimin e funksionit të auditimit të brendshëm sipas njërës nga mënyrat e përkufizuara me ligjin për auditim të brendshëm, themelimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm, themelimin e Njësisë së Përbashkët të Auditimit të Brendshëm me subjektet e sektorit publik të cilat nuk kanë Njësi të Auditimit të Brendshëm apo sigurimin e shfrytëzimit të shërbimit të auditimit të brendshëm të caktuar nga Ministria e Financave, me qëllim të shtimit të vlerës dhe përmirësimit të tërësishëm të kontrolleve të brendshme.			Nuk janë marrë masa.
3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku planifikimet fillestare të buxhetit janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.			Nuk janë marrë masa.
3.1.1 Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë se janë identifikuar të gjitha pronat në territorin e saj dhe të sigurojë se kryhet verifikimi i 1/3 të pronave që janë të regjistruara aktualisht.			Nuk janë marrë masa.
3.1.1 Të hyrat	Kryetari duhet të analizoj arsyet përse nuk janë ngarkuar me taksë vjetore të gjitha bizneset dhe të vendos mekanizma efektiv për inkasimin e borxheve, duke mos përjashtuara edhe masat ligjore apo masa tjera administrative.			Nuk janë marrë masa.
3.1.2 Pagat dhe mëditjet	Kryetari të sigurojë ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për një planifikim të stafit bazuar në nevoja reale, dhe mos të shpenzojë mjete për pozita të pa buxhetuara.			Nuk janë marrë masa.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet	Kryetari të sigurojë ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për respektimin e numrit të punësuarve sipas planifikimit të buxhetit për kodin e nën programit përkatës gjatë procesit të ekzekutimit të pagave.			Nuk janë marrë masa.
3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Kryetari duhet të sigurojë se faturat e pranuar paguhen brenda afatit ligjor, dhe të shqyrtohen mundësitë buxhetore për shlyerjen e faturave të trashëguara me shumë se një vit.			Nuk janë marrë masa.
3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Kryetari duhet të sigurojë se respektohet afati ligjor për mbylljen e avanseve duke siguruar llogaridhënie për paranë e shpenzuar.			Nuk janë marrë masa.
3.1.4 Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë se janë marrë veprimet e nevojshme për respektimin e kriterëve të Rregullores, me rastin e marrjes së vendimit për ndarjen e mjeteve financiare nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve.			Nuk janë marrë masa.
3.1.4 Subvencionet dhe transferet	Kryetari të sigurojë ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për azhurnimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve, të caktojë limitet e lejuara me qëllim të rritjes së transparencës dhe informimit të drejtë të publikut.			Nuk janë marrë masa.
3.1.5 Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se zyra e prokurimit do t'i respektojë të gjitha kriteret e përcaktuara, dhe se nuk nënshkruhet asnjë kontratë pa u plotësuar këto kriteret. Ndërsa në rast të mos zbatimit të kriterëve, të kërkojë përgjegjësi nga zyrtarët përgjegjës për zbatimin e kërkesave të rregullave të prokurimit.			Nuk janë marrë masa.

.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se procesi i regjistrimit të pasurisë dhe vlerësimit të tyre do të bëhet në një afat kohor sa më të shpejtë dhe të sigurojë se janë përfshirë të gjitha pasuritë në regjistrin kontabël. Të vendos kontrolle lidhur me mirëmbajtjen e automjeteve dhe të rishikohen arsyet përse automjetet të cilat kanë mundur të shfrytëzohen ende për nevoja të komunës, janë jashtë funksionit.			Nuk janë marrë masa.
3.2.2 Trajtimi i parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj	Kryetari duhet të sigurojë se do të ndërpritet kjo praktikë dhe të kërkoj nga zyrtarët përgjegjës që paratë e mbledhura të deponohen në llogaritë bankare brenda afateve të përcaktuara me rregulloret financiare dhe të reduktoj rrezikun për manipulime të mundshme.			Nuk janë marrë masa.
3.2.3 Të arkëtueshmet	Kryetari duhet të krijojë një qasje gjithëpërfshirëse në trajtimin e këtyre llogarive, duke vendosur mekanizma efektiv për reduktimin në nivel të pranueshëm të këtyre borxheve. Menaxhmenti duhet të inicioj një proces rivlerësimi, ku të gjitha llogaritë do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, shumave domethënëse, mundësive reale për inkasim dhe ushtrimin e masave administrative për inkasimin e tyre.			Nuk janë marrë masa.
3.3 Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të angazhoj personelin financiar të verifikoj faturat dhe t'i protokolloj në librin e faturave të papaguara si dhe duhet të ketë parasysh se detyrimet e tilla mund të ndikojnë në mos arritjen e objektivave sipas projeksioneve të parapara me buxhet.			Nuk janë marrë masa.

Shtojca III: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Komuna e Kllkot-Verbovci/Opština Klokot-Vrbovac/Municipality of Klokot-Vrbovac

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së **Kllkotit**, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Bozidar Dejanovic

Kryetar i Komunës,

Data: 08.Qershor.2018, **Kllkot**,

